



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 18/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muarrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 12.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.01.2011, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se në fshatin Shalë Komuna e Lipjanit në Qendrën e Votimit (QV) 1304E/01R rreth orës 10:37 nga komisionari i PDK-së Florent Hoxha dy persona i ka lejuar të votojnë pa u spërkatur gishtat fare vëzhguesi i LVV-së Behar Gashi ka raportuar parregullsinë në librin e votimit dhe menjëherë pas kësaj Arben Pajaziti vëzhgues. Florent Hoxha komisionar dhe Haqif Drenica koordinator, të gjithë anëtarë të PDK-së, që sipas parashtruesit të ankesës e kanë kërcënuar vëzhguesin e subjektit politik LVV-së Behar Gashi, duke i thënë që më nuk do të guxoj të raportoj apo të shënoj në librin e votimit. Më këtë parashtruesi i ankesës konsideron se është shkelur neni 4.2 i Rregullës i Zgjedhore nr. 09/2009.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. Këtë e bënë edhe më të besueshëm raporti i Policisë i datës 11.01.2011 për ditën e rivotimit të datës 09.01.2011 në fshatin Shalë komuna e Lipjanit, në të cilin theksohet se: stafi komandues i stacionit si dhe nga monitoruesit e zgjedhjeve në kuadër të stacionit ku sipas zyrtarëve të caktuar në qendër nuk ka pasur asnjë problem të raportuar e gjithashtu në kontaktin me menaxherin e qendrës se votimit që e kemi pasur nuk kemi pasur ndonjë ankesë në lidhje me procesin zgjedhor. Andaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 18/2011 më datën 12.01.2011

